



DOGANA E KOSOVËS - CARINA KOSOVA - KOSOVA CUSTOMS

31.10.2022

DALJE - IZLAZ - PASSING

Nr.BpNo. 01/1122/2022

Drejtoria Qendrore - Optba Uprava - Central Administration

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministarstvo za Finansije, Rada i Transfere – Ministry of Finance, Labour and Transfers



Dogana e Kosovës – Carina Kosova – Kosovo Customs

Udhëzues Doganor për vlerësimin e mallit

Ky udhëzues paraqet një udhërrëfyes te interpretimit te legjisacionit doganor qe rregullon vlerësimin e mallit për çështje doganore siç është e përcaktuar me Kodin Doganor dhe te Akcizave (03-L/109) dhe udhëzimin administrativ 11/2009 për implementimin e KDA-se, dhe duhet te lexohet se bashku me legjisacionin e cekur.

Udhëzuesi është i përpiluar ne baze te praktikave te mira qe zbatohen nga vendet e BE-se, dhe si i tille paraqet një dokument i cili do te përdoret nga zyrtaret doganor te cilët ne kuadër te përshkrimit te tyre te vendit te punës trajtojnë dhe mbikëqyrin vlerësimin e mallit.

Tabela e përbajtjes

1. Hyrje	4
1.1 Çka është vleresimi doganor	4
1.2 Për çka është e nevojshme vlera doganore	4
1.3 Ku gjendet legjislacioni që përfshinë vlerën doganore	4
1.4 Ku gjenden normat e detyrimeve të përcaktuara për mallrat.....	4
1.5 A përdoret vlera doganore për qëllime tjera	5
1.6 Si llogaritet vlera doganore	5
1.7 A kërkohet evidenca dokumentare për vlerësim	5
2. Metodat e vlerësimit për qëllime doganore.....	6
2.1 Metodat e vlerësimit	6
2.2 Si të përdoren metodat e vlerësimit	6
3. Metoda e parë (1) – Metoda e vlerës se transaksionit.....	6
3.1 Çka është vlera e transaksionit.....	6
3.2 Cili është çmimi i paguar	7
3.3 Çka nëse dogana konteston vlerën doganore të dekluaruar	7
3.4 Përkufizimi “të nderlidhur”	8
3.5 “Marrëdhënia” jo domosdoshmërisht vendimtare	8
3.6 Pranimi i vlerës se trankssionit	8
3.7 Çka duhet të shtohet në çmimin vertetë të paguar ose të pagueshëm	9
3.8 A ka ndonjë zbritje të lejueshme nga vlera doganore	11
3.9 Tarifat e zhdoganimit	12
3.10 Toleranca kohore	13
4. Metodat tjera të vlerësimit	13
4.1 Marrja parasysh e metodave tjera të vlerësimit	13
4.2 Metoda e dytë (2) – Metoda e mallrave identike	13
4.3 Metoda e tretë (3) – Metoda e mallrave të ngjashme	13
4.4 Metoda e katërtë (4) – Vlera e bazuar në çmimin për njësi (zbritjes).....	14
4.5 Metoda e pestë (5) – Metoda e vlerës se llogaritur.....	15
4.6 Metoda e gjashtë (6) – Te dhënat e disponueshme	15
5. Çka nënkupton termi ”Të dhënat e disponueshme”.....	15
5.1.Cilat janë burimet e të dhënavë të disponueshme	15
6. Vlerësimi i mallrave pa pagesë (free of charge)	16
6.1 Vlerësimi pa pagesë i mallrave zëvendësuese.....	16
7. Vlerësimi i mallrave të marra me qira ose me lizing.....	16
8. Mallrat e humbura, të dëmtuara ose me defekt	17
8.1 Dëshmi mbi mallin e humbur, të dëmtuar ose me defekt.....	17
8.2 Si llogaritet vlera doganore e rishikuar	17
8.3 Çka nëse mallrat gjenden të jenë me defekt pas importit	17

9.	Tarifat (pagesat) shtesë	18
9.1	Tarifat e transportit	18
9.2	Shpenzimet e transportit ajror	18
9.3	Shpenzimet postare	18
9.4	Shpenzimet e sigurimit	18
9.5	Shpenzimet e ngarkimit dhe trajtimit	19
9.6	Detyrimet dhe taksat e aplikueshme jashtë RKS-se	19
9.7	Shpenzimet (pagesat) që mund të përjashtohen	19
9.8	Dokumentet e transportit	20
10.	Vendi i hyrjes (paraqitjës).....	21
10.1	Vendi standard i hyrjes (paraqitjës).....	21
11.	Zbatimi i rregullave të vlerësimit në raste specifice	22
11.1	Blerja e kombinuar	22
11.2	Importi privat	22
11.3	Blerje me kredi	22
11.4	Artikujt e dorës së dytë (second-hand) ose të përdorura.....	22
11.5	Shitjet e njëpasnjëshme (sukcesive).....	22
11.6	Mallrat e importuara për shitje me dërgesë (sale on consignment)	23
11.7	Mallrat e importuara për shitje në Ankand	23
12.	Koha për qëllime vlerësimi	23
13.	Faturat dhe pagesat në monedha të huaja	23
13.1	Vendosja e normës së këmbimit	24
13.2	Pagesa e bërë me normë fikse të këmbimit	24
14.	Rregullat e vlerësimit për procedura specifice doganore	24
15.	Lirimi i mallrave para përcaktimit final të vlerës	24
	Shtoja A – Shembujt e dokumenteve të cilat mund të kërkohen nga dogana për qëllime të vlerësimit doganor	25
	Shtoja B –Lista kontrolluese	27

1. Hyrje

1.1. Çka është vlerësimi doganor?

Vlerësimi doganor përdoret për të përcaktuar vlerën e mallrave ne procedura të ndryshme doganore si import, eksport, magazina doganore, përpunim i brendshëm etj. Vlera doganore është esenciale për të përcaktuar shumën e sakte te çdo detyrimi doganor që duhet të paguhet për mallrat e importuara.

1.2. Për çka është e nevojshme vlera doganore?

Në shumicën e rasteve detyrimi doganor ngarkohet si përqindje e vlerës së mallrave që importohen “detyrimi ad valorem”. Në mënyrë që të llogaritet shuma e detyrimit të pagueshëm, fillimisht duhet të përcaktohet vlera doganore.

1.3. Ku gjendet legjislacioni që përfshinë vlerën doganore?

Legjislacioni qe përcakton rregullat e vlerës doganore është i përcaktuar në nenet 32 deri ne 40 te Kodit Doganor dhe Akcizave (KDA) dhe nenet 60 deri 92 te Udhëzimit 11/2009 për zbatimin e KDA-se.

Këto dispozita janë ne pajtim me Marrëveshjen për Implementimin e Nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT).

Parimet themelore të Marrëveshjes së OBT-së për vlerësimin doganor sipas Marrëveshjes për Zbatimin e Nenit VII të (GATT), janë si ne vijim:

- mbështetja kryesore në vlerën e transaksionit;
- unike në vlerësim;
- drejtësi dhe neutralitet;
- thjeshtësi dhe kritere të paanshme;
- në përputhje me praktikën tregtare.

Qëllimi i kësaj Marrëveshje dhe vendimeve ministrore te OBT-se, është krijimi i një sistemi të drejtë, neutral dhe të thjeshtë te përcaktimit te vlerës doganore, e cila do të pasqyrojë realitetin tregtar, te cilat në fakt janë parimet bazë të përcaktimit të vlerës doganore edhe në Doganen e Kosovës (DK).

1.4. Ku gjenden normat e detyrimeve të përcaktuara për mallrat?

Detajet për normat e detyrimeve doganore janë te përcaktuara ne Tarifën e Integruar te Kosovës (TARIK) e cila përbëhet nga Nomenklatura e Mallrave (kodet dhe përshkrimet) bazuar në Sistemin e Harmonizuar të Organizatës Doganore Botërore (WCO) dhe në Nomenklaturën e Kombinuar të Komunitetit Evropian.

Duke pasur parasysh se disa masa specifike të Kosovës nuk mund të trajtohen përbrenda kornizës së Nomenklaturës së Kombinuar, ka qenë e nevojshme që të krijohen nënkapituj shtesë në nivelin e TARIK-ut (shifra e 9 dhe 10).

1.5. A përdoret vlera doganore për qëllime tjera?

Në Republikën e Kosovës (RKS), vlera doganore kërkohet për:

- **Qëllime të TVSH-së**

Ne pajtim me nenin 64 te Ligjit ne fuqi për TVSH-ne është e përcaktuar si ne vijim:

“Dogana e Kosovës” në emër të ATK-së duhet të vlerësojë, ngarkojë dhe të bëjë mbledhjen e TVSH-së në importe, eksporte dhe në lidhje me aranzhimet tjera doganore, si dhe do të ndërmarrë funksione të tjera lidhur me administrimin e TVSH-së nëse kjo do të kërkohet”.

- **Për statistika të importit**

Për të prodhuar të dhëna statistikore ne lidhje me tregtinë me jashtë sipas ligjit ne fuqi.

- **Për disa kuota tarifore**

Kur një kuotë aplikon një kufizim të vlerësimit për mallra të caktuara të importit, siç është definuar në TARIK (p.sh. materiali X me vëllim total të kuotës prej XX €).

- **Për disa rregulla të origjinës**

Kur rregulli aplikon kriteret e vlerësimit (p.sh. prodhuesi i produktit X ku vlera e materialit jo-origjinues nuk tejkalon vlerën prej 40% të çmimit ex-works”)

1.6. Si llogaritet vlera doganore?

Ekzistojnë gjashte (6) metoda për llogaritjen e vlerës se mallrave për qëllime doganore. Megjithatë, metoda bazë e vlerësimit është metoda e parë – *metoda e vlerës se transaksionit*. Vlera e transaksionit përcaktohet si çmimi vërtetë i paguar ose te pagueshëm per mallrat e shtitura për eksport drejt territorit doganor te Republikës së Kosovës, i përshtatur sipas nevojës, ne përputhje me nenet 36 dhe 37 te KDA-se.

Metodae parë (1) duhet të shfrytëzohet para se të kalohet tek Metoda e dytë (2) dhe kështu me radhë. Detajet se si dhe kur duhet të përdoren metodat tjera të vlerësimit janë të përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4.

1.7. A kërkohet evidenca dokumentare për vlerësim?

Dogana mund të kërkoj dokumentacion dhe informata në lidhje me ndonjë import dhe metodat e vlerësimit të shfrytëzuara – shih shtojcën A.

2. Metodat e vlerësimit për qëllime doganore

2.1. Metodat e vlerësimit

Ekzistojnë gjashtë metoda të vlerësimit të aplikueshme për mallrat, dhe atë:

- | | |
|-----------------------------|-------------------------------------------------------|
| 1. Metoda e parë- | Vlera e transaksionit; |
| 2. Metoda e dytë- | Vlera e transaksionit të mallrave identike; |
| 3. Metoda e tretë- | Vlera e transaksionit të mallrave të ngjashme; |
| 4. Metoda e katërt- | Vlera e bazuar në çmimin për njësi (zbritjes); |
| 5. Metoda e pestë- | Vlera e llogaritur; |
| 6. Metoda e gjashtë- | Vlera që përdoret bazuar në të dhënat e disponueshme; |

Metodat e radhitura më lart duhet të aplikohen sipas radhës, megjithatë, importuesit mund të zgjedhin ndryshimin e rendit të aplikimit të metodave (4) dhe (5).

2.2. Si të përdoren metodat e vlerësimit

Metoda më e zakonshme e vlerësimit është vlera e transaksionit, e cila e aplikohet ne baze te çmimit te faturës. Kur është e mundur kjo është metoda që duhet përdorur. Vetëm atëherë kur metoda e vlerës se transaksionit nuk mund të përdoret, metodat tjera mund të merren parasysh. Në rastet e tillë vlera doganore përcaktohet duke kaluar sipas radhës në metodat tjera. Vetëm atëherë kur vlera nuk mund të përcaktohet sipas dispozitave të metodës së mëparshme me radhë, zbatohen dispozitat e metodës tjeter.

3. Metoda e parë (1) – Metoda e vlerës se transaksionit

3.1. Çka është vlera e transaksionit ?

Vlera doganore e mallrave të importuar është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose i pagueshëm për mallrat e shitura për eksport drejt territorit doganor te Republikës së Kosovës, i përshtatur sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37, duke u përshtatur sipas nevojës me pikën 3.8 të këtij udhëzuesi, me kusht që:

- (i) Nuk ka kufizime sa i përket disponimit ose shfrytëzimit të mallrave nga blerësi përveç kufizimeve të cilat:
- Janë imponuar, kërkohen me ligj ose nga autoritetet publike, p.sh. një licencë e importit;
 - Kufizojnë zona gjeografike në të cilën mallrat mund të rishiten; ose
 - Nuk ndikojnë në mënyrë thelbësore në vlerën e mallrave;

- (ii) Shitja ose çmimi nuk janë objekt i ndonjë kushti ose kërkese për shkak të cilave nuk mund të përcaktohet vlera doganore e mallrave që duhet të vlerësohen. Kur vlera e kushtit ose kërkese mund të përcaktohen, do të konsiderohet si një pagesë indirekte nga blerësi për shitësin dhe një pjesë e çmimit aktualisht të paguar ose të pagueshëm. Kjo aplikohet nëse kushti ose kërkesa nuk ndërlidhet me aktivitetet e ndërmarra nga blerësi në llogari të tij/saj, përvèç atyre për të cilat është dhënë një përshtatje në pikën 3.7.
- (iii) Asnjë pjesë e të ardhurave nga ndonjë rishitje pasuese, posdim ose shfrytëzim i mallrave nuk i kthehet drejtpërdrejt ose tërthorazi shitësit, përvèç nëse bëhet përshtatje sipas pikës 3.7 (f);
dhe
- (iv) Nëse blerësi dhe shitësi janë të ndërlidhur (shih pikat 3.4 dhe 3.5) vlera e transaksionit mund të përdoret për aq sa çmimi nuk ndikohet nga raportet në mes të palëve.

Kushti i vetëm të cilin duhet të plotësoj blerësi është që të jetë pale ne kontratën e shitjes. Ai/ajo nuk ka nevojë të jetë rezident ose i vendosur në RKS.

3.2. Cili është çmimi i paguar?

Çmimi aktualisht i paguar ose i pagueshëm është pagesa e përgjithshme e bërë ose që duhet të bëhet nga blerësi për, ose në interes të shitësit për mallrat e importuara. Çmimi përfshinë të gjitha pagesat e bëra ose që duhet të bëhen si një kusht për shitjen e mallrave të importuara nga blerësi tek shitësi. Pagesa jo domosdoshmërisht duhet të marrë formën e transferit të parave. Pagesa mund të bëhet përmes letër kredisë ose ndonjë instrumentit te negocieshëm. Mund të jetë i drejtpërdrejt ose jo. Një shembull i një pagesë indirekte do të ishte shlyerja e borxhit te shitësit nga blerësi.

3.3. Çka nëse dogana konteston vlerën doganore të deklaruar?

Kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme sa i përket vlerës së deklaruar se çmimi vërtetë i paguar ose i pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në territorin doganor, kur e konsideron te nevojshëm, dogana mund te njoftoj importuesin mbi bazën e dyshimit për vlerën dhe qëllimin e tyre për ta rregulluar vlerën në përputhje me rrëthanat. Atëherë kur rregullimi i propozuar do të ndikoj ne mënyrë te pafavorshme tek importuesi, nese kerkohet para se te merret vendimi perfundimtar nga dogana, importuesi mund të ketë mundësinë që të përgjigjet në kërkësen e doganës dhe të shprehin opinionin e tyre.

Nëse dogana pa kërkuar dëshmi shtese ose pasi që t'i kenë dhënë të drejtën importuesit për te ofruar dëshmi shtese, vendos për te mos pranuar vlerën e deklaruar, vendimi perfundimtar duhet t'i komunikohet me shkrim importuesit i cili brenda afateve ligjore mund te parashtroj ankesën tek Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve (SRV).

3.4. Përkufizimi “te ndërlidhur”?

Për qëllime te pikës 3.1 (iv) sistemi i vlerësimit i merr parasysh blerësin dhe shitësin si te lidhur mes vete nëse:

- Janë zyrtar ose drejtor ne bizneset e njeri tjetrit;
- Njihen ligjërisht si partner ne biznes;
- Janë punëtore dhe punëdhënës;
- Çdo person i cili direkt ose indirekt ka ne pronësi, kontrollon ose mban 5% ose me shume te fuqisë votuese ose aksionet nga te dyja bizneset;
- Njeri nga ata direkt ose indirekt kontrollon tjetrin;
- Te dy direkt ose indirekt kontrollohen nga një person i trete;
- Se bashku ata direkt ose indirekt kontrollojnë një person te trete; ose
- Janë anëtare te familjes se njëjtë.

Për qëllime te vlerësimit, personat, qofte fizik ose juridik, mund te jene te lidhur ne biznes me njeri tjetrin, për shembull njeri është agjent i vetëm i tjetrit. Ata do te konsiderohen qe janë te lidhur vetëm nëse janë me njeri-tjetrin ne marrëdhëniet e cekura me lart.

3.5. “Marrëdhënia “jo domosdoshmërisht vendimtare”?

Fakti qe blerësi dhe shitësi janë te lidhur brenda kushteve ne pikën 3.4 nuk është baze e mjaftueshme për te konsideruar vlerën e transaksionit te pa pranueshme. Kjo mund te jetë baze vetëm atëherë kur marrëdhënia ka ndikuar ne çmim dhe kjo ndikon qe metoda e vlerës e transaksionit te vlerësimit te mos përdoret. Importuesi ka mundësi qe te demonstroj qe vlera e transaksionit nuk është ndikuar nga marrëdhënia. Kur dogana ka baza qe te konsideroj qe marrëdhënia ka ndikuar ne çmim, ata duhet te komunikojnë bazat e tyre tek deklaruesi, me shkrim nëse kjo kërkon, dhe atij/asaj duhet t'i mundësohet qe te përgjigjet.

3.6. Pranimi i vlerës se transaksionit

Ne shitjen ne mes te personave te ndërlidhur, vlera e transaksionit po ashtu do te pranohet si vlere çdo here kur importuesi dëshmon se një vlere e tille është e përafërt per një nga rastet si vijon qe ndodhin në ose afërsisht ne kohen e importit:

- (i) Vlera e transaksionit ne shitjet ne mes te shitësve dhe blerësve qe nuk kane lidhje mes vete për mallrat identike ose te ngjashme për eksport ne RKS; ose
- (ii) Vlera doganore e mallrave identike ose te ngjashme, qe është përcaktuar sipas metodës se katërt ose metodës se pestë.

Duhet te theksohet qe është çështje e importuesit, dhe jo e doganës, për te vendosur nëse do te aplikoj këto mostra krahasuese. Atëherë kur mostrat aplikohen, duhet te merren parasysh dallimet e paraqitura ne nivelet komerciale, nivelet e sasive dhe rregullimeve shtese qe referohen ne pikën 3.7. Po ashtu duhet te merren parasysh shpenzimet e shkaktuara nga shitësi për shitjet tek blerësit me te cilët nuk janë te lidhur, te cilat nuk shkaktohen ne shitjet ne mes te blerësve me te cilët kane lidhje.

Mostrat mund te përdoren vetëm për qëllime te krahasimit. Ato nuk mund te përdoren për te vendosur vlerat zëvendësuese.

3.7. Çka duhet te shtohet ne çmimin vertetë te paguar ose te pagueshëm

Pagesat si ne vijim duhet te shtohen ne çmimin e pagueshëm (përveç nëse tashme janë përfshira):

- (a) **Shpenzimet e dërgesës:** Shpenzimet e transportit, sigurimi i dërgesës ose trajtimit i shoqëruar me dërgimin e mallrave ne kufirin e RKS-se. Shih piken 9 ne lidhje me pagesat shtese.
- (b) **Komisionet:** Pagesa te veçanta te komisionit ose ndërmjetësimit, përfshire komisionet e shitjes – shih pikën 9.7 për detaje tjera. Komisionet e blerjes përjashtohen nëse shfaqen ndaras nga çmimi paguar ose i pagueshëm për mallrat.
- (c) **Pagesat për të drejtën e autorit-pronësisë intelektuale (royalties)** dhe te drejtën e licencave ne lidhje me mallrat qe vlerësohen e qe blerësi duhet t'i paguaj, qofte direkt ose indirekt, si kusht për shitjen e mallrave qe po vlerësohen. Kjo behet vetëm kur nuk janë te shtuara tashme ne çmimin aktual te paguar ose te pagueshëm. Megjithatë, pagesat për te drejtën e autorit-pronësisë intelektuale dhe licencave nuk duhet te shtohen ne çmimin vërtet te paguar ose te pagueshëm kur ato përfaqësojnë pagesat për te drejtën për te riprodhuar mallrat e importuara ne RKS, ose pagesat e bëra nga blerësi për te drejtën për te shpërndarë ose rishitur mallrat e importuara nëse pagesat e tillë nuk janë kusht i shitjes për eksport te mallrave ne RKS.
- (d) **Kontejnerët dhe paketimet.** Deri ne atë mase qe shkaktohen nga blerësi dhe nuk përfshihen ne çmimin vërtetë te paguar ose te pagueshëm si ne vijim:
 - (i) Vlera e kontejnerëve, te cilat trajtohen si një njësi, për qëllime doganore, me mallrat ne fjale. Këto do te përfshinin, nder te tjera, kutitë e kamerave, kutitë e instrumenteve muzikore, ose kutitë tjera qe ne mënyrë specifike janë formësuar ose përshtatur për te përmbajtur artikuj specifik ose një set te artikujve. Ato duhet te jene te përshtatshme për shfrytëzim ne periudha afatgjata dhe te prezantohen me artikujt për te cilat janë destinuar. Atëherë kur kutitë i nënshtrohen importit te përsëritur, kostoja e tyre duhet, me kërkese nga importuesi, te ndahen proporcionalisht siç është e përshtatshme;
 - (ii) Kostoja e paketimit, qe përbën edhe koston e punës edhe te materialeve.

Kontejnerët qe referohen ne shkronjën (d) (i) si me lart, janë ato ku mbahen mallrat gjate kohës se importit dhe ne te cilat mallrat shiten ne rrjedhën normale te tregut. Kostoja e kontejnerëve te tillë duhet te përfshihet ne vlerën doganore. Vlera e çdo kontejneri, te cilat ne mënyrë te bindshme paraqiten se do te kthehen, mund te përjashtohen. Megjithatë, çdo pagesa e pagueshme nga importuesi ne lidhje me përdorimin e tyre ose kthimin e tyre tek dërguesi duhet te përfshihet. Kur vet kontejneri i nënshtrohet pagesave te detyrimeve doganore, vlera doganore e kontejnerit duhet

te përcaktohet ne pajtim me dispozitat e zakonshme te vlerësimit. Ne rastin e mjeteve te transportit siç janë kontejnerët transportues, kostoja e shfrytëzimit te kontejnerit përfshihet ne vlerën doganore si pjese e kostove te transportit.

Paketimi qe referohet ne shkronjën (d) (ii) si me lart, nënkupton çdo kontejner te jashtëm ose te brendshëm, mbajtëset, mbështjelljet ose mbështetësit përveç mjeteve te transportit (p.sh. kontejnerët e transportit), mushamat, pajisje transporti ose ndihmese. Kostoja e ndonjë paketimi te tille dhe materialet paketuese duhet te përfshihen ne vlerën per qëllime doganore.

(e) **Artikuj ndihmës:** artikujt qe nganjëherë njihen si ndihmës mund te furnizohen, qofte ose jo direkt dhe pa pagese ose me kosto te reduktuar, nga blerësi pre shfrytëzim ne prodhimin ose shitje te mallrave. Është e nevojshme qe te përcaktohet qe vlera e artikujve ndihmës nuk është përfshire ne çmimin aktualisht te paguar ose te pagueshëm. Ne rrethana te tilla, vlera e ndare proporcionalisht siç është e përshtatshme, duhet te përfshihet:

- (a) Materialet, elementet, pjesët dhe artikujt e ngjashëm te përfshira ne mallrat e importuara;
- (b) Vegla, matrica, kallëpet dhe artikujt e ngjashëm qe përdoren pre prodhimin e mallrave te produhuara;
- (c) Materialet qe konsumohen ne prodhimin e mallrave te importuara; dhe
- (d) Punët inxhinierisë, zhvillimore, punimet artistike, projektimet dhe planet e skemat (përveç skemave hulumtuese dhe preliminare projektuese) te realizuara diku tjetër përveç ne RKS dhe te nevojshme për prodhimin e mallrave te importuara.

Rrethanat krijohen kur veglat, matricat dhe kallëpet qe referohen ne shkronjën b) me lartë, janë te nevojshme për t'u shfrytëzuar ne prodhimin e mallrave te importuara. Kostoja e prodhimit te këtyre mjeteve mund te përfshihet ne vlerën e mallrave te importuara për qëllime doganore. Kjo behet kur kostot e tilla nuk janë përfshirë ne çmimin vërtet te paguar ose te pagueshëm. Ky është pozicioni pavarësisht nga fakti qe modeli aktual, kallëpi, etj., mund te fatuohen ndaras dhe mund te mos importohet me artikujt ose mallrat e produhuara ose fare.

Ndarja proporcionale e pagesave te tilla duhet te behet ne mënyre te arsyeshme te përshtatshme me rrethanat. Ekzistojnë mundësi te ndryshme. Vlera mundet, për shembull, te ndahet proporcionalisht:

- Ne dërgesën e pare, nëse importuesi dëshiron te paguaj detyrimin mbi vlerën ne tëresi përnjëherë; ose
- Mbi një numër te njësive te produhuara deri ne kohen e dërgesës se pare; ose
- Mbi prodhimin e parashikuar ne tëresi për te cilat kontratat ose zotimet e caktuara ekzistojnë për atë prodhim.

Metoda e ndarjes e përdorur do te bazohet nga dokumentacioni i siguruar nga importuesi.

(f) **Te ardhurat nga rishitja.** Vlera e çdo pjese te ardhurave nga ndonjë rishitje pasuese, disponimi ose shfrytëzim i mallrave te importit te cilat grumbullohen, qofte ose jo direkt tek shitësi.

3.8. A ka ndonjë zbritje te lejueshme nga vlera doganore?

Kur vlera bazohet ne çmimin e faturës, zakonisht lejohen disa zbritje me kusht qe ato zbritje janë te përcaktuara qarte ne dokumentet e krijuara nga shitësi.

Zbritjet: Këto zbritje mund te përjashtohen atëherë kur kane lidhje me mallrat e importuara qe vlerësohen dhe kur ka te drejta valide kontraktuale për zbritje ne kohen materiale kur ndodhe vlerësimi. Zbritjet (siç janë zbritjet rastësore ose retroaktive) ne lidhje me importet e mëparshme nuk mund te pretendohen ne tërësi ne importin aktual.

- (i) Zbritjet tregtare ose sasiore. Tregtari mund te mos përfshijë këto zbritje kur fitohen. Me fjale te tjera, çmimi neto i paguar ose i pagueshëm i këtyre zbritjeve është i pranueshëm. Nëse tregtari ka lidhje me shitësin, zbritjet do te lejohen nëse ajo marrëdhënie nuk ndikon ne çmimin e mallrave;
- (ii) Zbritjet ne para te gatshme dhe marrëveshjet paraprake. Tregtari po ashtu mund te mos përfshijë këto zbritje ne bazat ne vijim:
 - a. Kur pagesa qe reflekton zbritjen është bere ne kohen e lëshimit ne qarkullim te lire;
 - b. Nëse pagesa nuk është bere ne kohen e lëshimit ne qarkullim te lire, do te lejohet ne nivelin e deklaruar me kusht qe ato zbritje zakonisht pranohen brenda sektorit tregtar ne fjale;
 - c. Nëse zbritja është më e lartë se sa pranohet zakonisht brenda sektorit tregtar në fjalë do të pranohet vetëm nëse mund të dëshmohet, atëherë ku kërkohet, se mallrat janë shitura në fakt me çmimin e deklaruar si çmim vërtetë i paguar ose i pagueshëm dhe zbritja është ende e disponueshme në momentin e lëshimit ne qarkullim të lirë.

Kujdes duhet te tregohet kur ka zbritje, përveç atyre te cekura ne fature. Mund te ndodhin raste kur shprehja “zbritje “përdoret ne kuptim te veçante ose ne lidhje me rastet e veçanta, p.sh. kompensimi i defekteve gjate realizimit te porosive te mëparshme. Ne rastet e tillë dhe ne te gjitha rastet kur pretendohet një zbritje e natyrës jo te drejtpërdrejte, arsyetimi qe nënvízon zbritjen duhet te verifikohet.

Shpenzimet e dërgimit brenda RKS. Nëse shpenzimet e shitësit ose transportuesit përfshijnë dërgimin përtëj kufijve te RKS-se, shpenzimet shtese mund te zbriten për një dërgesë te tillë, me kusht qe deklarohen ndaras nga çmimi i paguar ose i pagueshëm për mallrat – shih piken 9.7 për detaje tjera.

Detyrimet dhe tatimet ne RKS. Detyrimet doganore ose tatimet tjera mund te zbriten nga çmimi i paguar ose i pagueshëm për te llogaritur vlerën doganore nëse ato janë te përfshira.

Dividentat: Pagesat e dividentëve te bëra për shitësin mund te zbriten.

Aktivitetet tregtare ne lidhje me mallrat e importuara. Importuesit mund te zbresin shpenzimin e aktiviteteve ne vijim, te cilat i kryejnë me shpenzime vetanake:

- Reklamimi
- Promovimi, ose
- Shërbimet garantuese

Veç kësaj, çdo pagese qe behet drejte mbështetjes se përgjithshme komerciale qe nuk kane lidhje me mallrat e importuara nuk duhet te përfshihen.

Shënim: shpenzimi i aktiviteteve te marketingut te bartura nga shitësi do te përfshihen ne vlerën doganore edhe nëse janë ngarkuar ndaras nga çmimi fatural i mallrave.

Kuotat e eksportit dhe pagesat për licenca. Pagesat për kuotat e eksportit dhe licencave mund te përjashtohen nga vlera doganore, mirëpo pagesat për certifikata te vërtetësisë për mishin duhet te përfshihen.

Tarifat e kamatës. Këto mund te përjashtohen nëse janë te pagueshme sipas marrëveshjeve financiare per blerjen e mallrave te importuara, me kusht qe këto tarifa deklarohen ndaras nga çmimi i paguar ose i pagueshëm per mallrat.

E drejta për riprodhim. Pagesat për këto te drejta mund te përjashtohen nëse deklarohen ndaras nga çmimi i paguar ose i pagueshëm për mallrat.

Punët pas importit. Tarifat për këto ne vijim mund te përjashtohen:

- Punët ndërtimore
- Ndërtimi
- Montimi
- Mirëmbajtja ose asistenca teknike për mallrat siç është fabrika industriale, makineria ose pajisjet e renda. Puna mund te realizohet para ose pas importit për aq sa realizohet si pjese për instalimin e mallrave te importuara dhe tarifat duhet te deklarohen ndaras nga çmimi i paguar ose i pagueshëm për mallrat.

Tarifat e menaxhmentit. Tarifat e menaxhmentit te paguara për shitësin mund te përjashtohen. Kjo do te përfshijnë tarifat për shërbimet e përgjithshme për administrim, marketing, kontabilitet, etj., te cilat nuk janë ne lidhje me mallrat e importuara.

3.9. Tarifat e zhdoganimit

Tarifat e zhdoganimit, qofte te përfshira ne çmimin fatural ose ndryshe te ngarkuara për importuesin, përfshihen ne vlerën e detyrimit vetëm deri ne atë mase kur janë ne lidhje me shpenzimet para importit.

3.10. Toleranca kohore

Nuk ka kufizim kohor brenda se cilës çmimi i paguar ose i pagueshëm mund te pranohet si vlore doganore. Ne pajtim me rrethanat, çmimi aktualisht i paguar ose i pagueshëm mund te pranohet si baze për vlerën doganore pavarësisht nga data e kontratës.

4. Metodat tjera te vlerësimit

4.1 Marrja parasysh e metodave tjera te vlerësimit

Shumica e importeve do jene pjese e vlerësimit sipas metodës se vlerës se transaksionit. Megjithatë, kur për shembull ngarkesat importohen me kushte tjera dhe nuk ka çmim vërtet te paguar ose te pagueshëm, atëherë vlera transaksionit nuk mund te përdoret. Atëherë duhet te përdoret metoda tjetër me radhe, metoda e “*mallrave identike*”.

4.2. Metoda e dyte (2)– Metoda e mallrave identike

Kjo metode definohet si vlera e transaksionit te mallrave identike te shitura për eksport ne RKS dhe te eksportuara në kohen ose përafërsisht gjate kohës se vlerësimit te mallrave.

Për përcaktimin e vlerës doganore sipas metodës se mallrave identike, shitja ne nivelin e njëjtë komercial dhe ne thelb sasi te njëjtë, duhet te përdoret për te përcaktuar vlerën doganore.

Kur një shitje e tille nuk ekziston, një shitje ne një nivel tjetër komercial dhe/ose sasi te ndryshme mund te përdoret. Rregullime te përshtatshme duhet te behen për te marre parasysh këto ndryshime. Kjo mund te behet vetëm kur provat janë ne dispozicion për te shfaqur qarte arsyeshmërinë dhe saktësinë e rregullimeve te tillë. Rregullimet po ashtu do te lejohen për te konsideruar ndryshimet domethënëse ne tarifa te transportit, trajtimit dhe sigurimit qe dalin nga ndryshimet ne distance dhe mënyrat e transportit.

Për caktimin e vlerës doganore sipas metodës se mallrave identike, përparësi duhet t'i jepet vlerës se transaksionit te mallrave te prodhua nga personi i njëjtë. Nëse një krahasim nuk është i mundshëm, atëherë vlera e transaksionit te mallrave te prodhua nga personi tjetër mund te përdoret. Nëse gjendet me shume se një vlore e transaksi te mallrave, vlera me e ulet duhet te konsiderohet për te përcaktuar vlerën doganore te mallrave te importuara.

Vetëm ato vlera doganore te mallrave identike te përcaktuara sipas metodës se vlerës se transaksionit mund te përdoren për te vendosur vlerën doganore sipas metodës se mallrave identike. Vlera doganore e vendosur, për shembull, sipas metodës se katërt nuk mund te përdoret.

4.3. Metoda e tretë (3) – Metoda e mallrave te ngjashme

Kjo metode definohet nga vlera transaksionit e mallrave te ngjashme te shitura për eksport ne RKS dhe te eksportuara ne kohen ose përafërsisht gjate kohës se vlerësimit te mallrave. Dispozitat e pikës 4.2 po ashtu aplikohen ne ketë metode vlerësimi. Ndryshimet këtu është se përdoren mallrat e ngjashme e jo ato identike.

Mallrat e ngjashme do te ndryshojnë ne disa aspekte nga mallra qe po vlerësohen. Ato duhet te kryejnë detyrat e njëjtë, te jene te prodhua ne vendin e njëjtë dhe te jene komercialisht te këmbyeshme me mallrat qe po vlerësohen.

4.4. Metoda e katërt (4) –Vlera e bazuar ne çmimin për njësi (zbritjes)

Kur përdoret metoda e bazuar ne çmimin për njësi, vlera doganore llogaritet ne baze te çmimit për njësi me te cilin mallrat janë shitur ne eksport ne RKS. Çmimi për njësi i përdorur mund te jetë per mallrat e importuara, identike ose te ngjashme. Ato duhet te shiten sipas kushteve qe janë importuar dhe ne sasinë me te madhe te grumbulluar. Blerësi dhe shitësi nuk duhet te jene te lidhur. Çmimi i nënshtronhet zbritjeve ne vijim:

- (i) secili komision qe zakonisht paguhet ose është arritur pajtimi per t'u paguar ose shtesat qe zakonisht behën per përfitim dhe shpenzime te përgjithshme ne lidhje me shitjet ne RKS te mallrave te importuara te klasit ose llojit te njëjte. Këto përfshijnë shpenzimet direkte dhe indirekte per marketingun e mallrave ne fjale;
- (ii) Shpenzimet e zakonshme te transportit dhe sigurimit dhe shpenzimet shoqëruese te shkaktuara brenda RKS-se; dhe
- (iii) Detyrimet doganore dhe taksat tjera te pagueshme ne RKS per shkak te importit ose shitjes se mallrave.

Çmimi për njësi përcaktohet si çmim ku numri me i madh i njësive është shitur ne nivelin e pare komercial pas importit gjate se cilës periudhe ndodh një shitje e tille.

Shitjet ne kohe ose përafërsisht gjate kohës se importit te mallrave qe vlerësohen, zakonisht duhet te shfrytëzohen ne ketë metode. Kur, megjithatë, shitje te tilla nuk ndodhin, shitjet ne datën me te hershme pas kësaj do te shfrytëzohen. Kjo me kusht qe shitjet e tilla ndodhin brenda 90 ditëve nga data e importit. Data me e hershme pas kësaj përcaktohet si data ne te cilën behet shitja e mallrave te importuara ose identike ose te ngjashme ne sasi te mjaftueshme per te vendosur çmimin per njësi.

Dispozitat po ashtu parashikojnë nëse importuesi kërkon qe një shitje e mallrave te importuara pas përpunimit te mëtejmë, mund te përdoret. Kjo mund te përdoret kur mallrat e importuara, identike ose te ngjashme nuk shiten ne RKS ne kushtet siç janë importuar. Kompensim i duhur duhet te behet per vlerën e shtuar nga përpunimet dhe zbritje te tilla te siguruara me lart.

Metoda e bazuar ne çmimin per njësi mund te përdoret me kusht qe per sa i përket shitjes pas importit, ka te beje me:

- blerësi dhe shitësi nuk janë te lidhur mes vete; dhe
- blerësi nuk ka furnizuar, qofte direkt ose jo, pa pagese ose me kosto te reduktuar, çdonjërin nga elementet, siç janë artikujt ndihmës, per shfrytëzim ne lidhje me prodhimin dhe shitjen per eksport te mallrave te importuara.

Stafi duhet te jene dijeni qe importuesit kane mundësinë qe te veprojnë sipas metodës se vlerës se përllogaritur para shfrytëzimit te metodës se zbritjes, nëse ata dëshirojnë.

4.5. Metoda e pestë (5) – Metoda e vlerës se llogaritut

Metoda e vlerës se llogaritut përdoret kur shitësi është prodhuesi aktual i mallrave dhe ka qasje ne te gjitha informatat ne lidhje me prodhimin e mallrave te importuara. Vlera doganore përcaktohet duke llogaritur shumen e elementeve ne vijim:

- i. Kostoja ose vlera e materialeve dhe fabrikimi ose përpunimet tjera te angazhuara ne prodhimin e mallrave te importuara;
- ii. Shuma e fitimit dhe shpenzimeve te përgjithshme. Shpenzimet direkte dhe indirekte te prodhimit dhe shitjes se mallrave për eksport te cilat nuk janë përfshire sipas shkronjës (i) me larte, do te përbenin një shpenzim te tille. Kjo shume duhet te jete e barabarte me atë qe pasqyrohet ne shitjen e mallrave te klasit ose llojit te njëjtë sikur edhe mallrat qe vlerësohen te cilat janë prodhuar nga prodhuesi ne vendin e eksportit për eksport ne RKS; dhe
- iii. Shpenzimet e transportit dhe sigurimit për mallrat e importuara.

Shpenzimi ose vlera qe referohet ne pikën (i) përfshinë shpenzimin e kontejnerëve dhe paketimit. Po ashtu përfshinë vlerën, te ndare siç është e përshtatshme, te artikujve te radhitur ne pikën 3.7 (e) (p.sh. artikuj ndihmës) me kusht qe ato te përdoren ne prodhimin e mallrave. Vlera e punës projektuese, etj., është e lejueshme deri ne atë mase qe i ngarkohet prodhuesit.

4.6. Metoda e gjashtë (6) – Te dhënat e disponueshme

Ne rrethanat e veçanta kur nuk mund te jete e mundshme për te përcaktuar vlerën doganore te mallrave te importuara sipas ndonjë nga metodat e vlerësimit te mëparshme, ne raste te tilla, vlera mund te përcaktohet duke aplikuar, ne mënyre fleksibile, cilëndo nga metodat qe janë me te përshtatshme për te mundësuar llogaritjen e vlerës doganore.

Gjate aplikimit te kësaj metode, nëse me shume se një nga metodat e zakonshme mund te zbatohen ne mënyrë fleksibile, radha e zakonshme e metodave alternative duhet te merret parasysh. Vlera doganore qe arrihet duhet te jete drejte, e arsyeshme, uniforme dhe duhet te pasqyroj realitetin komercial deri ne masën e mundshme.

5. Çka nënkupton termi "Të dhënat e disponueshme"

Si burimet të informacionit për krijimin e dosjes "*Të dhënat e disponueshme*" shërbejnë burimet e përcaktuara si më poshtë dhe që janë në zbatim të nenit 32-40 të Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosove, UA 11/2009 dhe parimeve të vlerësimit të Organizatës Botërore te Tregtisë WTO-së.

5.1. Cilat janë burimet e të dhënavë të disponueshme

- (i) Çmimet e mallrave ne tregjet ndërkombëtare, si REUTERS ose agjensione tjera ndërkombëtare;
- (ii) Katalogët për vlerësimin e automjeteve si "Schwacke Liste, Tretek" si dhe katalog tjerë te disponueshem dhe te zbatueshëm nga DK;
- (iii) Çmimet e publikuara nga Organizata Botërore e Tregtisë;

- (iv) Fatura te konfirmuara nga njesi organizative kompetente te Doganes;
- (v) Te dhënat statistikore te nxjerra përmes moduleve elektronike PKD, AW, etj;
- (vi) Ofertat dhe publikimet nga interneti;
- (vii) Buletinet e tjera zyrtare ndërkombe të që mund të përdorën ne vlerësimin e mallrave për qëllime doganore;
- (viii) Portalet dhe publikimet nga interneti (portale qe publikojnë çmime, te dhëna dhe studime te tendencave te tyre) qe mund të përdorën per vlerësimin doganor për çeliqe si: LME, COINS etj.

Megjithatë, sipas kësaj metode te vlerësimit, vlera doganore nuk duhet te bazohet ne:

- (i) Çmimin e shitjes te mallrave te prodhua ne RKS;
- (ii) Një sistem qe ofron pranimin e një alternative me te lart nga dy alternativa te vlerave;
- (iii) Çmimin e mallrave ne tregun vendor te vendit te eksportit;
- (iv) Koston e prodhimit, përveç vlerave te llogaritura te përcaktuara per mallrat identike/te ngjashme;
- (v) Çmimet për eksport te një vendi qe nuk formon një pjese te territorit doganor te RKS-se;
- (vi) Vlerën minimale doganore; ose
- (vii) Vlerat arbitrale ose fiktive.

Përgatitja dhe përditësimi i te “dhënavë te disponushme” ne doşjen e vlerës, kryhet nga Sektori i vlerës dhe miratohen nga struktura e linjës.

6. Vlerësimi i mallrave pa pagese (free of charge)

Metoda e parë nuk mund te përdoret për shkak se nuk ka çmim te paguar ose te pagueshmë, përveç nëse mallrat i janë nënshtruar një shitjeje me parë. Metoda e dytë (2) dhe e tretë (3) mund te përdoren dhe pastaj me radhe kalohet tek metodat tjera të vlerësimit.

6.1. Vlerësimi pa pagese i mallrave zëvendësuese

Nëse furnizuesi përfshinë ne ngarkese një sasi te artikuje “pa pagese” si zëvendësim për mallrat qe me gjase mund te jene me defekt ose te dëmtuara ne transit, çmimi i kontraktuar i shitjes mund te merret parasysh nëse mbulon sasinë totale te artikuje te transportuar.

7. Vlerësimi i mallrave te marra me qira ose me lizing

Metodat alternative te vlerësimit ndaj metodës se vlerës se transaksionit duhet te aplikohen për mallrat e importuara sipas marrëveshjes se marrjes me qira pasi qe nuk ka shitje te përfshire. Kur mallrat importohen sipas një marrëveshje për dhënie me qira ose lizing, nuk ka shitje ne mes te furnizuesit dhe importuesit. Megjithatë, para se te jepen me qira ose me lizing, mallrat mund t'i jene nënshtruar shitjes. Ne ketë rrethane, mund te jete e mundshme shfrytëzimi i metodës se parë (1). Përndryshe metodat nga 2 deri 5 po ashtu duhet te provohen.

Sidoqoftë, ne shumicën e rasteve, metoda 6-të do te jete e përshtatshme. Informata tjera sesi te llogariten vlerat për këto situata mund te kërkohen nga Sektori i Vlerës.

8. Mallrat e humbura, te dëmtuara ose me defekt

- Asnjë detyrim nuk është i pagueshëm për ndonjë nga mallrat qe janë transportuar me mungesa ose kane humbur ne transit para lirimit ne qarkullim te lire.
- Nëse dëmi ndodh para se mallrat te lirohen ne qarkullim te lire, vlera doganore mund te ndryshohet.

8.1. Dëshmitë mbi mallrat e humbura, te dëmtuara ose me defekt

Shembuj te dëshmive qe mund te pranohen janë si ne vijim:

- Një note kredie, nga shitësi;
- Një deklarate nga zyra doganore qe ka ekzaminuar mallrat;
- Një certifikate mbi dënimin/konfiskimin;
- Një deklarate nga një ekspert i pavarur; ose
- Detaje mbi zgjidhjen e pretendimit ndaj siguruesit ose transportuesit.

Lista me lart nuk është shteruese.

8.2. Si llogaritet vlera e rishikuar doganore?

Vlera e rishikuar doganore mund te llogaritet përmes:

- Ndorjes se çmimit original te paguar ose te pagueshëm per te marre parasysh humbjen ose dëmtimin e pjesshëm;
- Duke përdorur çmimin e rishikuar te paguar ose te pagueshëm kur shitësi redukton çmimin si rezultat i humbjes ose dëmtimit; ose
- Krahasimit te çmimit ne te cilin mallrat e dëmtuara janë shitura me vlerat mesatare te tregut te publikuara per llojin e njëjtë te mallrave ne kohen e shitjes dhe duke përdorur proporcionin e ndarjes se çmimit fatural.

8.3. Çka nëse mallrat janë gjetur te jene me defekt pas importit?

Nëse defektet janë riparuar dhe shitësi kompenson importuesin sipas garancisë per shpenzimet gjate punës se kryer nen garanci, një pretendim për kompensim te pjesshëm te detyrimit mund te konsiderohet. Detaje te plota te marrëveshjeve kontraktuale qe përfshijnë punën nen garanci duhet te sigurohen se bashku me dëshmitë qe:

- Zbulimi ose natyra e defektit (përfshire detaje te mjaftueshme për te identifikuar mallrat ne fjale);
- Punën riparuese te ndërmarrë dhe shpenzimet;
- Kompensimin e kostos se riparimit nga shitësi ne pajtim me kushtet e garancisë.

9.Tarifat (pagesat) shtesë

9.1 Tarifat e transportit

Shpenzimet e transportit te mallrave ne vendin e hyrjes (shih pikën 10) tashme mund te jene përfshire ne vlerën doganore. Ne rrethanat kur transporti është pa pagese ose sigurohet nga blerësi deri ne vendin e hyrjes, një shpenzim i llogaritur i transportit do te përfshihet ne vlerën doganore. Ne rastet kur tarifa aktuale e transportit dihet gjate kohës se përgatitjes se deklaratës doganore, një tarife e tille duhet te përdoret për te llogaritur vlerën e ngarkesës për qëllime doganore. Kostoja e transportit e shkaktuar pas arritjes ne territorin doganor te RKS-se nuk duhet te përfshihet ne vlerën doganore, me kusht qe një kosto e tille dallohet nga tarifa totale, p.sh. sigurohet një ndarje.

Ne rastet kur tarifa aktuale e transportit nuk dihet gjate kohës se zhdoganimi, ekuivalenti i asaj tarife do te aplikohet (siç është vërtetuar nga tarifa e transportit ne fjale për udhëtimin e njëjtë ose udhëtimin prapa dhe për llojin e njëjtë te ngarkesës).

9.2 Shpenzimet e udhëtimit ajror

Kur mallrat transportohen nga ajri ne mjetet e njëjta te transportit deri ne pikën matanë vendit te hyrjes, kostot e transportit duhet te vlerësohen ne proporcione me distancën e mbuluar jashtë dhe brenda territorit doganor te RKS-se. Kostot e transportit ajror qe duhet te përfshihen ne vlerën doganore përcaktohen sipas çmimeve ne AWB dhe cmimoreve tjera përkatëse qe zbatohen nderkombetarisht per transportin ajror.

Shërbimet e postave te Shpejta (SHPSH) bien ne kategorinë e “mallrave te transportuar përmes ajri”.

9.3 Shpenzimet postare

Ne rastin e mallrave te importuara përmes postes, te gjitha tarifat e grumbulluara deri ne vendin e destinacionit, me përjashtim te tarifave postare te grumbulluara ne vendin e importit, duhet te përfshihen ne vlerën doganore. Ne përcaktimin e vlerës doganore te ngarkesave jo komerciale te importuara përmes postes, nuk do te ketë zbritje te tarifave postare.

9.4 Shpenzimet e sigurimit

Kostoja e te gjithë sigurimeve te realizuara ne lidhje me transportin dhe trajtimin e mallrave duhet gjithnjë te përfshihen ne vlerën për qëllime doganore. Ne rast te policave te ndryshueshme, kur vlera e secilës ngarkese shlyhet kur arrin kundrejt shumes totale te sigruuar, shuma proporcionale e primit duhet te përfshihet ne vlerën e tille. Shih shembullin ne vijim sesi funksionon kjo ndarje:

Premia vjetore e përcaktuar – 3,500.00 €

Vlera totale e importeve gjate 12 muajve te mëparshëm – 1,750.000.00 €

Premia mund te shprehet si përqindje e vlerës totale te importeve.

$3,500/1,750.000 * 100 = 0.20\%$

Kjo përqindje mund te përdoret për te llogaritur shpenzimet e sigurimit për importet individuale te bëra gjate 12 muajve ne vijim.

Kur vlera totale e importeve përfshinë, për shembull, mallrat e siguruara ose jo te siguruara, ose te dyja importet e tatushme dhe jo te tatushme, përqindja mund te rregullohet nëse informatat relevante janë ne dispozicion. Kostot e sigurimit për te mbuluar rreziqet, përvëç rreziqeve ne transport deri ne portin ose vendin e hyrjes, nuk duhet te përfshihen.

Premia vjetore e përcaktuar 1,000.00 € ose me pak

Nëse sasia totale e premise vjetore është me pak se 1,000.00 €, shuma totale e premise duhet te përfshihet ne deklaratën e pare pas secilës date te ripërtëritjes vjetore.

9.5 Shpenzimet e ngarkimit dhe trajtimit

Te gjitha tarifat, përfshire tarifat e tillë te detyrimeve te porteve te huaja, tarifat e ngarkimit dhe "demurages" ne portet e huaja, ne lidhje me sjelljen e mallrave ne vendin e hyrjes, mund te përfshihen ne vlerën doganore.

(Demurages është një tarife ekstra e paguar si kompensim për vonesën e transportit te shkaktuar nga personi qe ka marr me qira dhe ka dështuar te ngarkoj me kohe para periudhës se nisjes se planifikuar).

